

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Makina 150 mijë euro e Grida Dumës, dhuratë nga Ergys Agasi?! Ja çfarë thonë Lolita dhe Elvi Fundo - REPORT.AL
ADRESA	https://report.al/makina-150-mije-euro-e-grida-dumes-dhurate-nga-ergys-agasi-ja-cfare-th-one-lolita-dhe-elvi-fundo/
BURIMI	report.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 15:53:42 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	24 shtator 2026, 15:41:16 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0574a124f2a60da2b893a201314bc00746b4addebbb7e6f733ea66bc90473bc3
TEKSTI	1cf381a3ebb5382431caa26a7d834216e5ca19699f65087da7ad86dc512d1817
PAMJA	87cb136729ccc6179a0fe521e2a3032d6c4c3cc52ddcf51ce3c51444e4bbe67d

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	c7f5b9d16ba179db9adca62160d16a32d05b34d5d8895de42ee1c9d78027b764
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	c206ef00f3c5688ec3d6505e364edf4e33bce2ceb75a58f689bcce7e176545ba
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/c7f5b9d16ba179db9adca62160d16a32d05b34d5d8895de42ee1c9d78027b764

PAMJA E FAQES


Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Home Aktualitet

Makina 150 mijë euro e Grida Dumës, dhuratë nga Ergys Agasi?! Ja çfarë thonë Lolita dhe Elvi Fundo

by Lajm Lajm — September 24, 2026 in Aktualitet, Kryesore

0
SHARES

Share on Facebook

X Share on Twitter

Në kulmin e debatit dhe kuriozitetit për çfarë përmban dosja "Agasi", faqja e njohur në FB, "Lolita", ka hedhur këtë të enjte një shënim të shkurtër "me spec", ku denoncon edhe përfshirjen e medias në këtë skandal.

"Asaj gazetares që i bleu makinë 150 mijë euro Ergys Agasi, kush do t'ia ndërrojë tani gomat, vaj e filtra? Se i shkojnë shtrenjtë shërbimet Range Roverit", shkruan Lolita, duke ngjallur kërkimin për këtë pjesëtare të medias shqiptare që vlerësohej kaq shtrenjtë nga "koordinatori i krimit të organizuar me Edi Ramën".

Nuk ka vonuar shumë dhe denoncimit-enigmë të "Lolita", i ka vënë emër gazetari Elvi Fundo, i cili e ka ndjekur nga afër dosjen dhe hetimin për organizatën e Ergys Agasit. Fundo ka ripublikuar në faqen e tij shënimin e "Lolita" dhe ka shtuar: **Mos e prek Gridën**.

Alfapress.al bëri një verifikim dhe rezultoi që në median shqiptare me emrin Grida rezultoi vetëm drejtuesja e emisionit "Top Story" në Televizionin Kombëtar Top Channel. Gjithashtu rezultoi se Grida Duma ka në përdorim vetjak një makinë luksoze tip "Range Rover".

Një ditë më parë në mbërmje, Grida Duma, ia kishte kushtuar emisionin e saj zhvillimeve të forta pas arrestimit në detyrë të drejtoreshës së SHISH, Vlora Hysenaj, dhe dosjes "Agasi". Kushdo që e pa arriti "në përfundim" se SPAK dhe një nga prokurorët që ka hetuar çështjen "Agasi", Altin Dumani, janë edhe më "të këqij" se Agasi dhe Hysenaj.

Gazetari Almer Toska deklaroi se Dumani është takuar me Belinda Ballukun në fshatin Zagori dhe aludoi edhe se është paguar deri në 20 milionë euro. Drejtuesja e emisionit Duma, e dëgjonte këtë akuzë të rëndë për një nga prokurorët që ka hetuar organizata të mëdha kriminale dhe politikanë të fuqishëm, përfshi dhe Agasin e Ramës, herë me ëmbëlsi dhe herë plot seriozitet, por në asnjë moment nuk kërkoi që gazetari të nxirrte faktet për publikun.

Në të njëjtin emision, analisti i përhershëm i Grida Dumës, Arjan Curri, lëshoi "bombën" tjetër. **"Prokurorët e SPAK kanë probleme seksuale"**, deklaroi ai me vetësigurinë që e karakterizon. Edhe në këtë moment drejtuesja e emisionit, Grida Duma, nuk kërkoi prova, por vetëm lëshoi atë nënqeshjen e saj epike-ironike.

Sa të vërteta janë lajmet që qarkullojnë jo zyrtarisht, kush dhe sa thellë janë të përfshirë njerëzit e medias në çështjen "Agasi" dhe jo vetëm, koha do ta provojë, por një gjë është e sigurt: **Fronti mediatik anti-SPAK është tërbuar dhe është hedhur në sulm të përqendruar. Shantazh, frikë apo të dyja bashkë? Të presim me durim./Alfapress.al**

Tags: Ergys Agasi grida duma

TË FUNDIT

Makina 150 mijë euro e Grida Dumës, dhuratë nga Ergys Agasi?! Ja çfarë thonë Lolita dhe Elvi Fundo

SEPTEMBER 24, 2026

Skandali/ A është Vlora Hyseni vetë agjente serbe?! Ja makina me të cilën erdhi nga Kosova

SEPTEMBER 24, 2026

Familja ishte në dasmë, hajdutët vjedhin banesën në Sarandë, zhduken 15 milionë lekë dhe bizhuteri

SEPTEMBER 24, 2026

Ndërtimi zhytet në borxhe, një e treta e ndërmarrjeve kanë hua më të madhe se kapitali

SEPTEMBER 24, 2026

Lodhja e vazhdueshme nuk duhet neglizhuar, 3 arsye që po ju shterojnë energjinë

SEPTEMBER 24, 2026

Njësimi i diplomave të huaja, ndryshojnë procedurat dhe dokumentet që duhet të dorëzojnë nxënësit

SEPTEMBER 24, 2026

Gjykata e Posaçme konfirmon masën "arrest shtëpie" për Vlora Hysenin

SEPTEMBER 24, 2026

Berisha denoncon skandalin: SHISH ka përgjuar edhe gazetarët

SEPTEMBER 24, 2026

Ulsi Manja "kalon" nga opozita, ç'po i thotë Berishës

SEPTEMBER 24, 2026

Përplasjet me policinë në protestë, 17 qytetarë janë shoqëruar në komisarate

SEPTEMBER 24, 2026

Previous Post

Skandali/ A është Vlorë Hyseni vetë agjente serbe?! Ja makina me të cilën erdhi nga Kosova



Lajm Lajm

report.al


REPORT.AL

Portali report.al është një media online e pavarur që sjell lajme, analiza dhe informacione të sakta në kohë reale. Me fokus tek transparencë dhe vërtetësia, portali synon t'u ofrojë lexuesve shqiptarë një burim të besueshëm lajmesh nga politika, ekonomia, shoqëria dhe ngjarjet ndërkombëtare.

RUBRIKAT

Aktualitet
OP-ED
Politike
Rajon
Showbiz
Sociale
Shëndet
Sport

MË TË KLIKUARAT



E rëndë në Dibër, 22-vjeçarja mbytet në lumin Drini i Zi

0 SHARES

01



Është studente ekselente, e birësuar nga një çift grek/ Trondit avokati: Bleona Mata është gjallë

0 SHARES



Gazetari trondit me deklaratën: Dyshime të forta për lidhjen e Neritan Nallbatit me Ergys Agasin

0 SHARES

© 2025 REPORT.AL

Aktualitet / OP-ED / Politike / Rajon / Showbiz / Sociale / Shëndet / Sport

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.